Universiteti i Prizrenit
University of Prizren
Univerzitet Prizrena
"UKSHIN HOTI"
Pranuar me datë 30.12.2019
Zyra e pranimit | Nr. i protokollit
308 | 01-494

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN
Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
Prizren, Republika e Kosovës;
Tel:+381 (0) 29- 232 140;
Homepage: www.uni-prizren.com

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË STUDIMEVE MASTER

Prizren, dhjetor 2019

Mbështetur në dispozitet e nenit 16 paragrafit 3 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës Nr.04\L-037 dhe të nenit 48 paragrafit 1 nën paragrafit 1.9, të Statutit të Universitetit Nr 04—V-621 i datës 30 maj 2013, Senati i Universitetit në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më: 27.12.2019, miratoi:

Rregulloren për përcaktimin e kritereve të studimeve master

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me Rregulloren e studimeve master *(në tekstin e mëtejmë- Rregullore)* përcaktohen: Mënyrat e organizimit të studimeve dhe llojet e tyre; kushtet për t'u regjistruar në studime; provimet dhe suksesi i tyre, si dhe organizimi përfundimtar i studimeve, deri në përgatitjen e punimit të diplomës master.

Neni 2

Organizimi dhe llojet e studimeve

Në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, organizohen studime të rregullta në nivelin master. Universiteti mund të organizoj studime master në bashkëpunim me Universitetet dhe Fakultetet e tjera përkatëse, kryesisht brenda kampusit, por organizon edhe në bashkëpunim me Fakultetet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Për këtë qëllim mund të ofroj programe dy lëndore dhe programe ndërdisiplinore të studimeve.

Neni 3

Studimet master kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë studentët, të cilët i kanë kryer studimet themelore (bachelor) dhe kanë fituar së paku 180 kredi (ECTS).

Në studimet master kanë të drejtë të regjistrohen edhe kandidatët, të cilët studimet themelore i kanë kryer jashtë vendit që njihen nga EUA-ja (Shoqata e Universiteteve Evropiane), ose institucionet që janë të pranuara nga një agjenci ndërkombëtare e akreditimit. Barasvlerësimin dhe nostrifikimin e çertifikatave dhe diplomave të jashtme e bën Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse.

Studentët e Universitetit të Prizrenit të cilët në studimet bachelor kanë arritur notën mesatare 8.0 e më lartë, mund të regjistrohen drejtpërdrejt në studime master.

Përzgjedhja e kandidatëve deri te numri i paraparë me konkurs bëhet sipas ranglistës prioritare të notës mesatare të arritur gjatë studimeve bachelor, ndërsa studentët me pikë të barabarta me notën 8.0 të Universitetit në rast të plotësimit të numrit me notë të njëjtë i nënshtrohen provimit pranues.

Studentët që kanë studiuar në Universitete dhe kolegje të tjera shtetërore apo private, ata pavarësisht notës mesatare do të seleksionohen pasi që janë përzgjedhur kandidatët që kanë studiuar në Universitetin e Prizrenit, dhe që i kanë plotësuar kriteret e parapara.

Në rastet kur numri i kandidatëve të paraqitur është më i vogël se numri i shpallur me konkurs atëherë mund të pranohen edhe studentë me notë mesatare nën 8.0 por ata do t'i nënshtrohen provimit pranues dhe kualifikues, mbi bazën e kritereve, të cilat i përcakton Fakulteti përkatës.

Neni 4

Të drejtën e dhënies së mësimit master e kanë personeli mësimor me titullin profesor *(profesor* i *rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent),* të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

Të drejtën e mbajtjes së ushtrimeve, seminareve në studimet master e kanë edhe asistentët, të cilët me së paku e kanë titullin shkencor magjistër ose PhDc, ose diplomë ekuivalente me atë.

Në raste të caktuara një lëndë mësimore mund ta mbajnë dhe organizojnë mësimin (më një plan dhe program) dy ose më shumë mësimdhënës.

Në rast kur mësimin e mbajnë më shumë mësimdhënës (në një lëndë) në sistemin e SMU-së shënohet emri i bartësit të lëndës.

Neni 5

Në Universitete të drejtën e organizimit të studimeve master e kanë këto njësi akademike:

1. Fakulteti Ekonomik,
2. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike,
3. Fakulteti i Edukimit,
4. Fakulteti Juridik,
5. Fakulteti i Filologjisë,
6. Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit.

Neni 6

Studimet master i udhëheq Dekani i Fakultetit përkatës. Listën e mësimdhënësve të propozuar nga Fakulteteti për realizimin e programit në studime master e aprovon Senati i Universitetit.

Neni 7

Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teorike, punës praktike, punës në teren, ekskursioneve, vizitave studimore profesionale dhe shkencore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmes punimeve të pavarura të studenteve.

Studimet master përfundojnë kur studenti mbron publikisht temën master dhe arrin thirrjen shkencore master i shkencave në profilin e caktuar.

Neni 8

Kushtet e regjistrimit në studime

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, regjistron studentë sipas mundësive kadrovike dhe teknike, të nevojave të shoqërisë dhe tregut. Propozimin për regjistrimin e studentëve të rinjë e jep Fakulteti përkatës dhe e miraton Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren. Vendimin përfundimtar për shpalljen e konkursit publik e bënë Senati i Universitetit.

Neni 9

Përzgjedhja e kandidatëve sipas nenit 3 *(tre)* të kësaj Rregulloreje e bënë Komisioni përkatës më së paku 3 (tre) anëtarë, të cilët janë të zgjedhur nga Këshilli i Fakultetit.

Komisioni duhet të jetë kompetent dhe profesional sipas fushës së studimeve, poashtu Komisioni në bashkëpunim me Dekanin e Fakultetit e shpall listën e kandidatëve që kanë aplikuar. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në studimet master mund të ushtrojnë ankesë me shkrim Këshillit të Fakultetit *(komisionit të ankesave)* brenda tre ditëve të punës pas publikimit të rezultateve.

Vendimi përfundimtar për ankesën e ushtruar merret në afatin prej dy ditësh pune pas përfundimit të afatit të ankesës.

Neni 10

Regjistrimi i studentëve në semestrin e parë në studimet master bëhet në Administratën e Universitetit, kurse ID kartelën e studentit e nënshkruan Sekretari i Përgjithshëm i

Universitetit .

Neni 11

Me rastin e konkurimit kandidatët duhet të sjellin këto dokumente:

- ✓ Ekstraktin e lindjes;
- ✓ Diplomën origjinale *(çertifikatën)* e kryerjes së Fakultetit me rastin e regjistrimit (ndërsa pas regjistrimit ajo mund të zëvendësohet me të noterizuar;
- ✓ Për studentët që kanë studiuar jashtë vendit, kërkohet edhe vendimi për njohjen e diplomës;

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

- ✓ Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit;
- ✓ Dy fotografi (formati *4,5 x 6 cm.),*
- ✓ Pagesën në lartësi të përcaktuar nga Universiteti "Ukshin HOTI" Prizren.

Dokumentet e dorëzuara nga studenti me rastin e regjistrimit mbeten në zyrën e shërbimit të studentëve. Shërbimi i studentëve bën regjistrimin e studentëve të rinjë në librin amzë, në programin e veçantë në kompjuter dhe formon dosjen e studentit. Studentët që nuk iu përgjigjen datave të planifikuara për regjistrim, e humbin të drejtën e regjistrimit.

Neni 12

Ndërrimi i programit dhe transferimi nga Universitetet tjera

Për ndërrimin e programit të studimit ose transferimit nga Universitetet tjera publike vendore dhe ndërkombëtare, vlejnë dispozitat e parapara me Statutin e Universitetit "Ukshin HOTI" në Prizren, dhe me rregulloret e brendshme të Fakulteteve.

Neni 13

Kohëzgjatja e studimeve

- ✓ Studimet master zgjasin 2 (dy) vite, katër semestra dhe në çdo semestër me dhënien e provimeve fitohen nga 30 ECTS, që do të thotë se për përfundimin e këtyre studimeve duhet të arrihen 120 kredi të ECTS-së.

- ✓ Studenti mund të përsërisë vitin e njëjtë të studimeve më së shumti një herë si student i rregullt, dhe ju nënshtrohet pagesave administrative sipas Udhëzimit Administrativ nga MASHT-i,
- ✓ Studenti i cili nuk e ka fituar të drejtën e regjistrimit pas përsëritjes së dytë të regjistrimit e humb statusin e studentit të rregullt.
- ✓ Studenti mund të kërkoj edhe një herë gjatë studimeve që t'i lejohet vazhdimi i studimeve edhe për një vit *(në raste të jashtëzakonshme),* Kërkesa duhet të miratohet në njësinë akademike.
- ✓ Studenti mund të kërkoj pezullim të përkohshëm të studimeve në këto raste: sëmundjet e rënda, kujdesin për fëmijët nën moshën 3 (tri) vjeçare, dhe në raste të tjera të justifikueshme. Kërkesa duhet te miratohet në njësinë akademike.
- ✓ Fillimi dhe mbarimi i semestrave mësimor bëhet sipas dispozitave të Statutit të Universitetit.
- ✓ Mësimi në studimet master zhvillohet në 15 (pesëmbëdhjetë) javë për një semestër.

Neni 14
Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit

1. Personi i regjistruar në Universitetin "Ukshin HOTI" në Prizren, e ka statusin e studentit të rregullt. Statusi i studentit dëshmohet me ID kartelën e studentit, në rast të humbjes së ID kartelës me lejen e Dekanit të Fakultetit, studentit mund t'i sigurohet ID kartela e re.

1.1 Kërkesës për ID kartelë të re duhet t'i bashkëngjitet dëshmia se dokumenti është shpallur i pavlefshëm dhe se është bërë pagesa sipas Rregullores.

2. Studenti e humb statusin e rregullt në këto raste:

2.1 Kur me dëshirë i lëshon studimet *(me kërkesë të veçantë),*

2.2 Kur t'i ketë përfunduar studimet,

2.3 Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve,

2.4 Komisioni disiplinor i Universitetit i përjashton nga Fakulteti studentët të cilët i shkelin rregullat e përcaktuara me Rregulloren për procedurën disiplinore të Universitetit.

Neni 15
Të drejtat dhe obligimet e studentëve

Studentët kanë këto të drejta:

1. Të marrin pjesë në ligjërata, ushtrime teorike, ushtrimet laboratorike, mësim praktik, punë në teren, seminare, diskutime shkencoro-mësimore, konsultime profesionale, ekskursione me karakter mësimoro-shkencor si dhe në forma të tjera të mësimit që organizohen me plan dhe program mësimor;
2. Të përdorin pajisjet e Fakultetit sipas rregullave përkatëse për mësim dhe ushtrime mësimore.
3. Të shfrytëzojnë bibliotekën e Fakulteteve në pajtim me rregullat përkatëse mbi punën e bibliotekës;
4. Të marrin pjesë në zgjedhjet e studentëve për përfaqësimin e tyre në organet e Fakultetit dhe të Universitetit;
5. Të marrin pjesë në mbledhjet e organeve dhe Komisioneve ku janë caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe përgjegjësi;
6. Të përfitojnë bursa studimi dhe shpërblime të veçanta, që jepen nga Fakulteti apo nga Universiteti, atëherë kur i plotësojnë kushtet;
7. Të kërkojnë lirimin nga pagesa e tarifës së regjistrimit, kur i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs që e publikon Universiteti;
8. Të kërkojnë të njihen me rregullat e përcaktuara mbi studimet master në Fakultet.

Neni 16

Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore të studentëve rregullohet me Rregulloren për procedurën disiplinore të Universitetit të Prizrenit.

1. Studenti i cili nuk i përmbahet detyrimeve ligjore dhe statutore sipas kësaj rregulloreje apo të ndonjë vendimi të Dekanit të Fakultetit, gjatë tërë kohës së studimeve, bën një shkelje të obligimeve dhe për këtë përgjigjet në aspektin disiplinor dhe ligjor.
2. Me rregulloren mbi procedurën disiplinore të Universitetit, përcaktohen shkeljet e lehta apo të rënda të detyrimeve të studentit, përcaktimi dhe procedura e përgjegjësisë disiplinore, shqiptimi i masave disiplinore si dhe të drejtat për ankesat e studentëve.

Neni 17

Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të shqiptuar nga organet e Fakultetit që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre. Ankesat e tilla i dorëzohen Senatit të Universitetit , brenda 8 (tetë) ditësh të punës pas shpalljes së vendimit.

Senati i Universitetit , brenda 30 (tridhjetë) ditësh të punës pas pranimit të ankesës, merr vendimin përfundimtar.

Neni 18

Kushtet e regjistrimit të vitit

1. Studenti ka të drejtë të regjistroj vitin e dytë të studimeve, nëse i ka dhënë 50% të provimeve, nga numri i përgjithshëm i provimeve, ose i ka fituar 30 (tridhjetë) kredi nga lëndët mësimore, të vitit të parë të studimeve;
2. Studenti nuk mund të hyj në provime të vitit të dytë, pa i përfunduar provimet e vitit të parë,
3. Regjistrimi i vitit të parë bëhet në kohën e përcaktuar me konkurs,
4. Regjistrimi i vitit të dytë bëhet sipas kritereve të përcaktuara me statut;
5. Vërtetimi i semestrave bëhet prej 01-15 tetor për semestrin dimëror dhe 01-05 mars për semestrin veror,
6. Studenti paguan tarifat administrative dhe ato të shkollimit sipas Udhëzimit Administrativ nga MASHT-i.

Neni 19

Provimet dhe suksesi në provime

Studentët janë të obliguar dhe kanë të drejtë të paraqesin dhe t'i nënshtrohen provimeve. Provimet merren nga të gjitha lëndët e parapara me planin e studimeve, pas përfundimit të mësimit të lëndëve përkatëse. Studenti fiton të drejtën për të iu nënshtruar provimeve nga lënda pasi t'i kryen obligimet që parashihen me programin mësimor.

Provimet mbahet me shkrim, gojazi ose me shkrim dhe gojazi.

Kur provimi përbëhet prej pjesës me shkrim dhe gojazi, studenti mund të hyj në provimin gojazi , vetëm atëherë kur në pjesën me shkrim ka marrë notën pozitive.

Për përcaktimin e suksesit akademik të studentit, mund të aplikohen edhe format e punës, si: kolokfiumi, punimi i seminarit, testi dhe ushtrimet praktike.

Neni 20

1. Orari i provimeve shpallet publikisht në web-faqe të njësive akademike përkatësisht në web-faqen e universitetit.

Provimet për studimet master mbahen në afatet dhe datat e përcaktuara dhe të publikuara në tabelën e njoftimeve në Fakultet, dhe në faqen zyrtare të Universitet, www.uni-prizren.com.

2. Afatet e rregullta të provimeve janë:

Afati i janarit (fillon prej 20 janar deri më 15 shkurt),

Afati i qershorit (fillon prej 6 qershorit deri më 30 qershor),

Afati i shtatorit (fillon prej 7 shtator deri më 30 shtator).

3. Afatet e paraqitjes së provimeve bëhen sipas afateve të parapara në studimet bachelor.

Neni 21

Suksesi i studentit në provim shprehet me notën 5 *(pesë)*, deri në 10 *(dhjetë)*. Nota shënohet me numër dhe me tekst në procesverbalin, të cilin pedagogu e pranon nga sisitemi i SMU-së.

Fletëparaqitjet dhe procesverbali i provimit dërgohen në shërbimin e studentëve, i cili më së largu 3 ditë pas mbajtjes se konsultimeve dhe vendosjes se notave në sistemin SMU-së, shërbimi i studentëve fletëparaqitjet e notave të studentit i vendos në dosje.

Provimet janë publike dhe shpallen në tabelën e shpalljeve në departamentet përkatëse si dhe në sistemin e SMU-së.

Gjatë shpalljes së rezultateve në tabelën e shpalljeve duhet të ruhet privatësia e studentëve rezultatet shpallen me nr. të ID kartelës.

Neni 22

1. Studenti ka të drejtë t'i parashtroj ankesë me shkrim Dekanit,
2. Studenti shprej pakënaqësinë e notës së marrë në provime,
3. Ka të drejtë rishikimin e testit të dorëzuar dhe të vlerësuar nga mësimdhënësi.

2. Ankesa duhet të parashtrohet brenda 48 (dyzet e tetë) orësh, pas shpalljes së rezultateve të mbajtjes së provimit.

Neni 23

Punimi i diplomës, teza për master

Studimet master në Universitetin "Ukshin HOTI" në Prizren, përfundojnë me mbrojtjen e

punimit master, në pajtim me programin e studimeve.

Studenti i cili i ka kryer obligimet e parapara me planin dhe programin mësimor të studimit përkatës, fiton të drejtën të marr temën master.

Studenti mund të aplikoj për parashtrim të temës master me rastin e regjistrimit të semestrit të 4-të (katërt).

Studentët të cilët i kanë kryer provimet në afat rekord ose me minus një provim e fitojnë titullin e absolventit dhe nuk paguajnë një vit nëse i kanë të paguar semestrat 3 dhe 4.

Studentët të cilët i kanë kryer provimet në afat rekord, por për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të diplomojnë, e paguajnë semestrin e fundit dhe tarifat e diplomimit.

Hulumtimi në punimin e temës së masterit duhet të zgjas deri në 3 (tre) muaj.

Neni 24

Mësimdhënësit me kontratë të rregullt pune në njësinë e caktuar akademike dhe të cilët mbajnë mësim në nivelin e studimeve master gjatë vitit akademik i propozojnë Këshillit të Fakultetit deri në 10 (dhjetë) tituj të ndryshëm të temave për punimin e master për secilën lëndë veç e veç brenda programit të veçantë të studimeve. Mësimdhënësi i cili i ka propozuar temat është mentor potencial i atyre temave.

Një mësimdhënës, gjatë një viti akademik në Fakultetin Ekonomik dhe Juridik mund të mentoroj deri në 15 (pesëmbëdhjetë) kandidatë brenda një viti, 3 (tre) kandidatë janë në kuadër të normës së rregullt dhe 12 (dymbëdhjetë) kandidatë janë me pagese brenda vitit, ndërsa në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, 3 (tre) kandidat në kuadër të normës dhe 7 (shtatë) me pagesë brenda vitit, të bazuar në Rregulloren e Këshillit Drejtues të Universitetit. Ndërsa mësimdhënësi njëkohësisht mund t'i udhëheqë deri në 5 (pesë) kandidatë, numër i cili mund të përcillet me kandidatët vijues.

Tabela nr. 1.2. nga Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin "Ukshin Hoti"

Normat e temave për mentorin në kuadër të normës dhe pagesa në nivelin e studimeve bachelor dhe master:

Grupimet e njësive akademike	Mentorimi i temave të masterit me pagesë (mentori)
Grupi 1	Deri 10/ vit

Grupi 2	Deri 13/ vit
Grupi 3	Deri 15/ vit

Grupi i 1-rë përfshin: Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, Fakultetin e Shkencave Kompjuterike,

Grupi i 2-të përfshin: Fakultetin e Filologjisë dhe atë të Edukimit,

Grupi i 3-të përfshin: Fakultetin Juridik dhe Fakultetin Ekonomik.

Tabela nr. 1.2. nga Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe Komisionet e Përhershme në Universitetin "Ukshin Hoti"

Burimi: (Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin "Ukshin Hoti" e datës 18.01.2019 si dhe plotësimi i saj sipas vendimit të datës 15.03.2019)

Neni 25

Punimi master punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike dhe praktike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve kërkimore në fushën shkencore për të cilën është përcaktuar studenti.

Neni 26

Propozimi me shkrim për lejimin e temave për punimin master duhet të përmbajnë: Titullin me arsyetimin e temës së propozuar, qëllimin shkencor të punimit, tezat themelore që do të merren për bazë dhe instrumentet që do të zbatohen në realizimin e hulumtimit.

Neni 27

Fakultetet kanë Komisione për filtrimin e temave dhe tezave të punimit ku vlerësimi nga Komisioni dhe propozimet dërgohen për shqyrtim në Këshillin e Fakultetit i cili miraton titujt e propozuar nga mësimdhënësit dhe lejon hartimin e punimit master për kandidatët.
Me këtë rast Dekani në koordinim me Këshillin Mësimorë Shkencor të Fakultetit emëron mentorin i cili e udhëheq studentin gjatë punës për punimin e diplomës ose tezës master.

Neni 28

Punimi master, paraqet punim të pavarur profesional të kandidatit me të cilin tregon që ka përvetësuar njohuritë teorike dhe praktike dhe mund të parashtron dhe zgjidh probleme dhe detyra profesionale dhe shkencore.

Neni 29

Punimi master duhet të ketë prej 50-80 faqe të formatit A4. Referencat shënimet në fund të faqes nuk përfshihen në këtë përllogaritje. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthejë në vete fushën kërkimoro-shkencore sipas programit studimor përkatës.
Lloji i shkrimit në *Times New Roman*, madhësia e shkronjave në tekst duhet të jetë 12, hapësira midis rreshtave (*space line*) duhet të jetë 1.5.

Neni 30

Punimi dorëzohet në 5 (pesë) kopje në lidhje të fortë në administratën e njësisë akademike ku studion kandidati 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së mbrojtjes së punimit master.

Neni 31

Kandidati në afat prej më së largu 1 (një) vit pas vërtetimit të semestrit të katërt dhe pas dhënies së provimit të fundit duhet të dorëzoj dorëshkrimin e punimit për vlerësim.
Me kërkesë të kandidatit, Dekani i Fakultetit mund të cakton afat shtesë më së shumti deri në 6 *(gjashtë)* muaj për të dorëzuar punimin e diplomës master.
Arsyet për shtyrjen e afatit e vlerëson Këshilli i Fakultetit përkatës. Në qoftëse kandidati nuk e dorëzon dorëshkrimin e punimit për vlerësim në afatin e caktuar me këtë nen, kandidati duhet të rifilloj procedurën për lejimin e punimit me temë të re, përkatësisht ta rikthej statusin e studentit të rregullt në pajtim me statutin e Universitetit.

Neni 32

Pas dorëzimit të dorëshkrimit të punimit master për vlerësim nga Dekani i Fakultetit, me propozim të Këshillit të Fakultetit përkatës, ngrit komisionin për vlerësimin e punimit master në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së paraqitjes së kërkesës nga kandidati.
Detyrë e komisionit është që pas vlerësimit të punimit, t'i paraqet raport me shkrim përmes Dekanit, Këshillit të Fakultetit në afat jo me të gjatë se 1 (një) muaj. Komisioni për vlerësim të punimit master, me shumicë të anëtarëve të vetë, i propozon Këshillit që punimi të miratohet dhe kandidatit t'i lejohet mbrojtja, ose punimi të plotësohet apo punimi të refuzohet.
Anëtari i komisionit i cili nuk pajtohet me propozimin nga alineja paraprake e këtij neni është i detyruar që mendimin ta ndaj dhe ta paraqet në formë të shkruar.

Neni 33

Komisioni për vlerësimin e dorëshkrimit të punimit master përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve,

prej të cilëve njëri është oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij për punim. Sipas nevojës, Dekani i Fakultetit mund të formoj komisionin prej 5 (pesë) anëtarësh. Anëtar të komisionit mund të jenë mësimdhënësit me titullin e profesorit (profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent).

Neni 34

Në bazë të propozimit të Komisionit Vlerësues, Dekani i Fakultetit merr vendim për lejimin e mbrojtjes publike të punimit master. Komisioni për Mbrojtje formohet në përbërje të përcaktuar me nenin e 32 të kësaj Rregulloreje. Mentori nuk mund të jetë kryetar i komisionit për mbrojtjen publike të punimit master.

Neni 35

Në qoftë se punimi i kandidatit refuzohet nga komisioni përkatës ose kandidati për shkaqe të tjera nuk e bën plotësimin e punimit në afatin sipas nenit paraprak, kandidati ka të drejtë që të paraqet propozimin me shkrim për titullin e ri të punimit master. Këtë mundësi kandidati mund ta shfrytëzoj vetëm njëherë.

Neni 36

Në qoftë se Këshilli i Fakultetit i'a kthen kandidatit punimin për ta plotësuar, me atë rast mundet ta zgjeroj komisionin për vlerësimin e punimit të plotësuar.

Kandidati duhet të bëj plotësimin e punimit master në afatin më së largu gjashtë muaj.

Kur Komisioni pranon punimin e plotësuar, është i obliguar që të harton raport të ri për vlerësimin e punimit dhe të njëjtin t'ia dërgon Dekanit në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, prej ditës kur e ka pranuar punimin.

Neni 37

Punimi master i vlerësuar pozitivisht nga anëtarët e komisionit, në afatin prej 7 (shtatë) ditësh mbetet ne diskutim publik. Gjatë diskutimit publik, punimi jepet në dispozicion që të shikohet nga të interesuarit të cilët mund të japin vërejtje dhe sugjerime eventuale.

Pas përfundimit të afatit të diskutimit publik mentori në konsultim me anëtarët e komisionit, administrata, dhe kandidati e caktojnë datën e mbrojtjes, njoftimi për mbrojtjen publike shpallet nga sekretari i njësisë akademike përkatëse në afat prej 7 (shtatë) ditë para mbrojtjes së punimit master përmes njoftimit në web-faqe dhe në tabelën e shpalljeve.

Neni 38

Këshilli i Fakultetit përkatës pas kalimit të afatit nga neni paraprak dhe miratimit të

raportit të Komisionit mbi vlerësimin pozitiv të punimit master, e formon Komisionin për Mbrojtjen Publike të punimit master. Komisioni në marrëveshje me kandidatin e cakton datën dhe vendin (sallën) e mbrojtjes publike të punimit.

Mbrojtja publike e punimit master duhet të bëhet brenda afatit, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 7 (shatë) ditë dhe as më i gjatë se 30 (tridhjetë) ditë prej ditës se nxjerrjes së vendimit.

Neni 39

Sekretari i Fakultetit bënë lajmërimin për mbrojtjen e punimit master 7 (shtatë) ditë para ditës së mbrojtjes. Lajmërimi jepet në tabelën e shpalljeve të Fakultetit, dhe në web-faqen e Universitetit.

Në lajmërim paraqiten të dhënat për kandidatin, Komisioni për Mbrojtje, titulli i punimit dhe informatën se mbrojtja është publike.

Neni 40

Procedura e mbrojtjes

Kryetari i Komisionit e hap seancën për mbrojtjen publike të punimit master, paraqet të dhënat lidhur me procedurën e zhvilluar deri në nxjerrjen e vendimit mbi lejimin e mbrojtjes të punimit si dhe paraqet të dhënat biografike dhe bibliografike të kandidatit.

Mentori në pika të shkurtra paraqet raportin e vlerësimit të punimit para komisionit dhe audiencës për vlerësimin e punimit master.

Kandidati bën një prezantim paraqitje të përmbledhur të punimit, por jo më gjatë se 20 (njëzetë) minuta. Anëtarët e Komisionit përmes pyetjeve që ia shtrojnë kandidatit dhe përgjigjeve të tij, e bëjnë verifikimin e autorësisë së punimit dhe vlerësojnë nivelin e njohjes së problematikës që trajtohet në punim.

Neni 41

Kryetari i Komisionit e bënë përfundimin e mbrojtjes dhe fton komisionin që të vendos për të bërë vlerësimin dhe marrë vendimin përfundimtarë për shpallje të rezultatit të mbrojtjes publike.

Vendimi i Komisionit shpallet publikisht para auditoriumit.

Neni 42

Kandidati ka mbrojtur punimin master nëse shumica e anëtareve të Komisionit kanë dhënë vlerësimin pozitiv për mbrojtjen e punimit. Punimi vlerësohet me notë prej 6- 10. Nota e punimit mund të jetë për 2 nota më e larte se nota mesatare.

Nëse kandidati nuk e ka mbrojtur me sukses punimin master, ai mund të paraqet propozim të ri të punimit master brenda 6 (gjashtë) muajve prej ditës së njoftimit se nuk e ka mbrojtur publikisht punimin master.

Neni 43

Pas përfundimit të studimeve dhe mbrojtjes me sukses të punimit master, kandidati fiton titullin "master shkencor në fushës përkatëse". Pas fitimit të titullit "master shkencor", kandidati nga shërbimet përkatëse të Universitetit, pranon çertifikatën dhe diplomën e nënshkruar nga Dekani dhe Rektori.

Fakulteti dhe Universiteti mbajnë evidencën e studentëve të diplomuar në studimet master.

Neni 44

Kandidatit, titulli i masterit mund t'i kontestohet, dhe t'i merret nëse konstatohet se punimi master është plagjiaturë, ose është në ndonjë formë tjetër i falsifikuar.

Në rast të dyshimit të bazuar, Dekani i Fakultetit formon komisionin prej tre anëtarëve që të shqyrtoj dyshimet e paraqitura lidhur me punimin e masterit.

Këshilli i Fakultetit e shqyrton raportin e Komisionit dhe nëse konstaton dyshimet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, i propozon Senatit të Universitetit marrjen e titullit master, kandidatit i cili ka falsifikuar.

Senati i Universitetit të Prizrenit e merr vendimin përfundimtar për marrjen e thirrjes së masterit.

Neni 45

Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

Rregullorja miratohet nga Senati i Universitetit "'Ukshin Hoti" Prizren, por për të gjitha çështjet tjera mbi të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universiteti dhe Ligji mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

Obligohen njësit akademike që të hartojnë Rregullore të brendshme sipas specifikave të programeve studimore.

Rregullorja hyn në fuqi nga dita e miratimit nga ana Senatit të Universitetit. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje mund të bëhen sipas procedurës me të cilën është miratuar.

Kryesuesi i Senatit të Universitetit

Prof. Asoc. Dr. Ismet TEMAJ

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI _____

STUDIME MASTER

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel.+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, më _____ **Nr. 01.** _____

Për: Këshillin e Fakultetit:_____

Projekt- propozimi i temës dhe tezave të punimit master

Programi Studimor: _____

Emri dhe mbiemri i studentit: _____

Emri dhe mbiemri i mentorit të propozuar:_____

Titulli i temës së propozuar:

(*Të shënohet edhe në gjuhën Angleze*)

_____

Hyrje

Qëllimi i studimit:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

Objektivat e studimit:

Thekso problemin i cili do të hulumtohet dhe sqaro pse ky problem është i rëndësishëm për t'u hulumtuar:

Aktualiteti i studimit:

Njohuritë aktuale në fushën e studimit:

(Të gjitha punimet që i konsulton me qëllim të kuptimit dhe hulumtimit të problemit kërkimor)

Metodologjia e hulumtimit:

(Mënyra se si do ta zhvillohet studimi, metodat e përdorura etj.)

Hipotezat e studimit:

(*Te shtrohen hipotezat*)

_____

_____

_____

_____

_____

Përmbajtja e punimit sipas kapitujve dhe titujve:

HYRJE

Qëllimi i hulumtimit

Metodologjia e punimit

Formulimi i problemit

KAPITILLI 1

1.....

2....

KAPITULLI 2

1.....

2....

KAPITULLI 3

1.....

2....

KAPITULLI 4

1.....

2....

KAPITULLI 5

1.....

2....

KAPITULLI 6

1.....

2....

LITERATURA

1.....

2....

3.....

.....

.....

15.

Literatura:

Nënshkrimi i mentorit-es

Nënshkrimi i studentit

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI _____

STUDIME MASTER

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel.:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, më _____ **Nr. 01.** _____

FAKULTETI _____

Programi: _____

Kandidati/ja: _____ **ID:**_____

Lënda: Kërkesë për aprovimin e temës dhe tezave të PUNIMIT MASTER, me titull:

_____

_____

Mentori i propozuar: _____ _____

Komisioni:

1. Prof. _____. Dr. _____Kryetar/e_____
2. Prof. _____. Dr. _____Anëtar/ e _____
3. Prof. _____. Dr. _____Anëtar/e _____
4. Prof. _____. Dr. _____ Anëtar/e _____
5. Prof. _____. Dr. _____ Anëtar/e: _____

Vendimi i Komisionit:

_____

_____

_____

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI _____

STUDIME MASTER

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. ref. 02 - **Prizren, më:**

FAKULTETI _____

Programi:

_____

Lënda: Kërkesë për formimin e Komisionit për Vlerësimin e PUNIMIT MASTER, me titull:

_____

_____

_____

Mentori:

_____

Emri dhe Mbiemri i kandidatit-es: Nr. ID-së

_____ _____

Dekani i Fakultetit _____ **Fakulteti** _____

Ref. nr.

Prizren, _____

SHTOJCA 3

PROTOKOLI MBI MBROJTJEN E PUNIMIT MASTER

Komisioni hyn në sallën ku do të mbahet mbrojtja. Kandidati qëndron para Komisionit.

Anëtarët e Komisionit dhe të tjerët që janë prezent ulen, e pastaj Kryetari i Komisionit lexon materialet:

Të nderuar anëtar të Komisionit dhe të gjithë ju që jeni prezent,

Ju njoftoj se sot kandidati -kandidatja

_____

emri e mbiemri i kandidatit

Do të mbrojëpunimin Master me titull

Titulli i punimit	

i punuar nën udhëheqjen e mentorit-mentores

	Thirrja, emri e mbiemri	*Institucioni, shteti*
Mentori		
Bashkëmentori		

Punimi Master do të mbrohet para Komisionit prej tre anëtarëve në përbërje:

Komisioni i zgjedhur për mbrojtje të punimit të Masterit	***Thirrja, emri e mbiemri***	***Institucioni, shteti***	***Nënshkrimi***
	1.		
	2.		
	3.		

Të cilin e ka emëruar Këshilli i Fakultetit me datën pas miratimit të Raportit të vlerësimit të punimit,

Kryetari i Komisionit e lexon CV-në e shkurtër të kandidatit (të sjell nga kandidati në maksimum ½ e faqes A4):

Mentori e lexon raportin e shkurtër lidhur me rendësin e punimit të kandidatit (të hartuar nga Mentori)

Pasi që e ka lexuar raportin, Kryetari i jep fjalën kandidatit me këto fjalë:

E lusim kandidatin-en që ta prezantoj punimin Master, mundësisht brenda 20 minutave.

Pasi ta përfundon prezantimin kandidati-ja, Kryetari i Komisionit kërkon nga anëtarët e Komisionit që të parashtrojnë pyetjet nga lëmia e hulumtimit.

Kryetari i pyet të pranishmit: Në fund Kryetari dhe anëtarët e Komisionit i parashtrojnë pyetjet kandidatit:

I lutemi audiencës që t'i parashtroj pyetje kandidatit nëse eventualisht ka të tilla.

Nëse ka, ju lutem ta depononi pyetjen te Komisioni dhe të vetë prezantoheni.

Pyetjet nga të pranishmit i parashtrohen kandidatit përmes Komisionit.

Kryetari e përmbyll procedurën me fjalët:

Nëse nuk ka më pyetje Komisioni tërhiqet për të marrë vendim.

* * *

Pas kthimit në sallë Kryetari lexon: Vendimin .....

Në bazë të punimit të diplomës Master, përgjigjeve dhe sqarimeve të dhëna nga kandidati,

në pyetjet e anëtareve të Komisionit, Komisioni u tërhoq dhe morri këtë:

Në mbështetje të nenit 88, pika 3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, nenit 42 të Rregullores për organizimin e studimeve Master dhe vendimit nr. 01/____, datë _____._____.2019,

Këshilli Mësimor i Fakultetit përkates ka emëruar Komisioni Profesional në përbërje:

1. Prof. _____. Dr. _____Kryetar/e
2. Prof. _____. Dr. _____Anëtar/e
3. Prof. _____. Dr. _____ Mentor/e

Pasi analizoi dhe vlerësoi ekspozenë dhe përgjigjet në pyetjet e parashtruara të mbrojtjes publike të PUNIMIT MASTER, të kandidatit-es, Komisioni njëzëri mori:

V E N D I M

Kandidati/ja _____, me datë: ____/____/ ___, e ka mbrojtur me sukses PUNIMIN MASTER me titull:

_____, në programin

_____.

Konform nenit **88,** pika **3,** të Statutit të Universitetit "Ukshin HOTI" Prizren dhe nenit 42 të Rregullores

mbi studimet Master, fitoi titullin akademik:

MASTER_____**në**_____,

me çka i fitoi të gjitha të drejtat sipas ligjit në fuqi.

Mbrojtja filloi në ora _____ dhe mbaroi në ora _____

Dekani

_____

ANËTARËT E KOMISIONIT:

1. Prof. _____. Dr. _____Kryetar/e _____

2. Prof. _____. Dr. _____ Anëtar/e _____

3. Prof. _____. Dr. _____ Mentor/e _____

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI _____

STUDIME MASTER

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. ref. 03 - **Prizren, më:**

PROCESVERBAL PËR MBROJTJEN PUBLIKE TË PUNIMIT MASTER

Kandidati-ja,

_____

Më _____ mbrojti para komisionit projekt-propozimin dhe përmbajtjet e tjera të parapara me Rregulloren për përcaktimin e kritereve të Studimeve Master në Universitetin ''Ukshin Hoti'' Prizren.

Komisioni në përbërje të plotë, në takim të veçantë bëri vlerësimin e Punimit Master dhe të mbrojtjes së përmbajtjeve të parapara për mbrojtjen publike të Punimit Master, dhe konstatoi se:

Kandidati- ja ka mbrojtur me sukses PUNIMIN MASTER dhe është vlerësuar me notën

_____

Kanditati-ja ka kryer studimet Master në Fakultetin _____ dhe merr titullin **MASTER** _____ **në** _____.

Mbrojtja filloi në ora _____ dhe mbaroi në ora _____.

Zyra për Master

_____

ANTARËT E KOMISIONIT

1. Prof. _____ Dr. _____ Kryetar/e _____
2. Prof. _____ Dr. _____ Anëtar/e _____
3. Prof. _____ Dr. _____ Mentor/e _____

SHTOJCA 6

UDHËZUES STANDARD PËR HARTIMIN E PUNIMIT MASTER

Ballina

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN (fonti 20)

FAKULTETI _____(fonti 18)

Programi _____(fonti 16)

PUNIM MASTERI (fonti 28)

TITULLI I TEMËS (më së shumti 14 fjalë, fonti 20)

Mentori-e: Kandidati-ja:

Titulli, Emri mbiemri Emri mbiemri

Prizren, muaji, viti

Faqja e parë (në gjuhen shqipe dhe Angleze)

TITULLI I PUNIMIT

Faqja e dytë

Deklarata e autorësisë

Faqja tretë

ABSTRAKTI

(abstrakti duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe angleze)

Faqja e katërt

PËRMBAJTJA

Faqet në vijim:

HYRJA

(Qëllimi i hulumtimit, Metodologjia e punimit, formulimi i problemit, përkufizimet dhe terminologjia, përshkrimi i kapitujve dhe etapave të punës, vendndodhja e hulumtimit)

Kapitulli 1,2,3,4,5– SHTJELLIMI I MATERIALIT

(varësisht nga problematika)

Kapitulli i fundit- PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

(Prezantimi i rezultateve të arritura, prezantimi i problemeve që kërkojnë zgjidhje të mëtutjeshme)

LITERATURA

SHTOJCAT

(Varësisht nga departamenti ose programi studimor, përshembull vizatimet, pyetësorët, udhëzuesit, etj.

Pavarësisht nga madhësia e tyre ato duhet të radhiten dhe të palosen në formatin e letrës A3, përkatësisht A4).

Faqja e dytë

TITULLI I TEMËS

ABSTRAKTI

Në punimin master, kërkesat për formatimin duhet të përfillen sipas udhëzuesit, dhe sipas të dhënave si në vijim. Disa nga rekomandimet për shkrimin e punimit mund të merren drejtpërdrejt nga udhëzuesi PDF format apo MS Word format.

Ju lutemi që në vijim të këtij udhëzuesi ta bëni hartimin e punimit duke respektuar tipin e shkronjave, tekstin, hartimin e tabelave, referencave dhe mënyrës së referimit, apo citimit.

Punimi Master do të publikohet në formën elektronike *Portale Document Format (PDF)* në web-faqen e Universitetit . Abstrakti duhet të përmban deri 200 (dyqind) fjalë dhe duhet të jetë në faqen e tretë dhe të katërt të punimit. Abstrakti duhet të jep shpjegimin e shkurtër për qëllimin e punimit dhe rezultatet e pritura.

FJALËT KYÇE: duhet të shkruhen 3- 5 fjalë kyçe.

HYRJA

Pritet që kandidati të paraqesë të shkruara me kujdes materialet dhe të dhënat e hulumtuara, të shkruara dhe të lekturuara me kontroll, të kujdesshëm për drejtshkrimin dhe gramatikën.

Numri i faqeve të hyrjes duhet të jetë 2-4 faqe. Në hyrje duhet qartësisht të përshkruhen fushat e studimit të temës, puna e kandidatit, metodat e përdorura, rezultatet dhe konkluzionet për diskutim të: çështjeve të hulumtuara apo të

projektuara, propozimet për studimin e mëtutjeshëm të çështjeve të hulumtuara. Punimi duhet të hartohet në gjuhën shqipe (mësimore përkatëse sipas statutit).

Terminologjia teknike duhet të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare, ligjet dhe Rregulloret në fuqi.

1. FORMATIMI I PUNIMIT

Unifikimi i punimit bëhet për të harmonizuar standardin e aplikuar në kuadër të Universitetit. Për këtë arsye sugjerohen kandidatët që të përdorin shembullin e modelit si në vijim.

Margjinat janë *normal,* me 1.5"- 35mm në të majtë dhe me 1"-25 mm në të djathët, lartë dhe poshtë.

Të gjitha rreshtat dhe paragrafët e tekstit duhet të jenë të ndara *1.5 spaced*, me rreshtin e parë të shmangur për 10 mm. *Double spacing* duhet të përdorët vetëm para dhe pas titujve dhe nëntitujve, siç janë të prezantuar në këtë shembull. Pozicionimi, përbërja dhe stili i titujve dhe nëntitujve duhet të jetë sipas këtij shembulli.

Nuk duhet të ketë ndarje midis paragrafëve.

1.1 Header, Footer, Numri i faqes

Kandidatët duhen të bëjnë *header*-it sipas këtij shembulli. Në *footer* duhet të vendoset në qendër numri i faqes.

1.1.1 Fonti

Për shkrimin e punimit të DMA-së, përdorët 12-*point Times Nev Roman font*, duke përdorur stilet *e bold, italic and underlined.* Rekomandohet që teksti në figura, në tabela të jetë jo më i vogël se 11-*point Arial Narrow font.*

2.1 Tabelat dhe figurat

Titujt e figurave dhe të tabelave duhet të jenë të vendosura në krye të tyre, për të shpjeguar përbërjen e figurës apo tabelës pa pas nevoj t'i referohemi tekstit. Shifrat dhe tabelat që nuk përmenden në tekst nuk duhet të paraqiten. Më poshtë është një shembull për tabelën 1.

Tabela 1. Titulli i tabelës

Tipet e komponentëve nanometrik	Madhësia (nm)	Varainca (nm)

CuO	47	4.2
NiO	35	6.4
Al_2O_3	42	2.1
SnO_2	27	3.9

Burimi: (autori 2018)

Tabelat dhe figurat duhet të vendosen afër tekstit ku janë të referuara. Të gjitha tabelat dhe figurat duhet të jenë të numëruara me numrat Arab. Titujt e tabelave duhet të vendosur në qendër të rreshtit dhe titulli i saj në krye të tabelës. Figura duhet të jetë e vendosur në qendër të rreshtit dhe titulli i saj pas figurës, siç është e prezantuar në Figurën 1.

Figure 1: Number of patents on nano technology with time



Burimi: autori 2019

Figura 2: Përgjigjet e pyetësorit në pyetjet e parashtruara



Burimi: Autori 2019

Figure 3: Salla multifunksinale pa mbështetës të ndërmjetëm



Burimi: Autori 2019

2.2.1 Ekuacionet

Çdo ekuacion duhet të paraqitet në një rresht të veçantë nga teksti me një hapësirë bosh mbi dhe nën. Ekuacionet duhet të jenë të qarta dhe shprehjet e përdorura duhet të shpjegohet në tekst.

Ekuacionet duhet të numërohen në vij të rreshtit, siç tregohet në shembullin mëposhtëm (1)- (2).

Në çdo rast sistemi i ekuacioneve duhet të shkruhet si në vijim:

$$\frac{\partial \rho}{\partial t} = -\nabla \cdot (\rho \mathbf{u}) \tag{1}$$

$$\rho\left(\frac{\partial}{\partial t} + \mathbf{u} \cdot \nabla\right)\mathbf{u} = -\nabla P + \rho \mathbf{g} + \frac{1}{c}\mathbf{J} \times \mathbf{B} \tag{2}$$

Shtojcat

Varësisht nga departamenti ose programi studimor, përshembull, vizatimet, pyetësorët, udhëzuesit, etj, duhet të ndahen dhe të vendosen pas tekstit kryesor të punimit. Pavarësisht nga madhësia e tyre ato duhet të radhiten dhe të palosen në formatin punimit të diplomës Master, formatin A4, përkatësisht A3.

Diskutimi i rezultateve të hulumtimit

Përfundime

Përfundimet duhet të tregojnë shpjegimin e shkurtër të rezultateve rreth hulumtimit gjatë etapave të punës (max. 1 faqe). Sugjerohet të jepen edhe hapat e mëtutjeshëm të hulumtimit për çështjet të cilat mund të rekomandohen.

Rekomandime

Rekomandimet duhet të deklarojnë në mënyrë të saktë propozimet më të rëndësishme të punimit të DMA-së (Diploma Master), si dhe pikëpamjet e kandidatit për implikimet praktike të rezultateve.

Literatura

Literatura e duhur duhet të përfshihet gjatë tërë tekstit, kurse lista e referencave duhet të vendoset në këtë kapitull apo seksion, sipas listës së referencave të radhitura në mënyrë alfabetike dhe si: (a) citimi i referencave në tekstin kryesor, shtojcat, tabelat dhe të dhënat duhet të bëhen duke përdorur mbiemrin e autorit (të dy autorëve, ose kur me shumë se dy, atëherë autori i parë plus et. al.).

Shembull: "... si të llogaritur më parë (Jones et al, 1989.)", Ose "... siç tregohet nga Jones et al (1989).". Për dy ose më shumë publikime të botuar në të njëjtin vit nga i njëjti autor(ët), shtoni a, b, c, etj, të vitit të tilla si (1980) ose (1980b) së bashku dhe citon si Jones et al. (1980, b); (b) Lista e të gjitha referencave të cituara (duke përfshirë edhe kuotat, burimet në tabela, figura apo dhe shtojca) në mënyrë alfabetike sipas: mbiemrit, inicialet e emrit të autorit të parë dhe të tjerëve, viti i botimit, titujt e kumtesave, patentave dhe librave apo kapitujve, monografive, numrat e faqeve fillestare dhe përfundimtare duhet të përfshihen. Shkurtimet e emrave të revistave shkencore, duhet të jenë në përputhje me përdorimin e shkurtesave origjinale dhe ndërkombëtare.

Referimet e faqeve të internetit *websites*: rritja e informacionit të dobishëm që mund të gjendet në internet, duhet të raportohet sipas referencës nga faqja e internetit.

Në fund të listës së referencës, të bëj një seksion të veçantë i faqeve dhe datën e qasjes në ato.

Megjithatë, shumë shpesh referencat e faqeve të internetit në diplomën e masterit duhen referuar si web-1, Web-2, etj.

Për shembull, në tekstin e punimit: "... është treguar se me transferimin e nxehtësisë ka rritje 40% (Web-1) ...".

Numri i referencave në fazën e parashtrimit të jetë jo më i vogël se 10 (dhjetë) njësi bibliografike, ndërsa në fazën e mbrojtjes studenti duhet të shfrytëzoj së paku 20 (njëzetë) njësi bibliografike.

Mitchell, J.W.,Beckman, W.A. 1995. Instructions for IBPSA Manuscripts, SEL, University of Wisconsin, MadisonUSA.

Plan, Z.A., Lin R.T. and Richer, J.A. 1989. Nanotechnology Devices in "The World of Nanotechnology, G.E. Good fellow and A.T. Mann, Eds., Butterworth Publishers, Boston, MA, pp. 61–67.

Kryesues i Senatit të Universitetit,

Prof. Asoc. Dr. Ismet TEMAJ